

BANKA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT

NJOFTIM PËR MARRJE ME QIRA TË AMBJENTEVE PËR NEVOJA TË PUNONJËSVE TË BANKËS SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT

Banka Shqiptare e Zhvillimit, e themeluar në bazë të Ligjit nr. 23/2025 “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit” dhe në zbatim të Statutit, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe funksionale pas fillimit të aktivitetit institucional, si dhe për plotësimin e nevojave për ambiente pune të përshtatshme për stafin e saj, në zbatim të nenit 7 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ligjit 10296 / 2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, njofton se kërkon të marrë me qira ambiente për zyra, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara më poshtë:

I. SPECIFIKIME TEKNIKE

Kritere të detyrueshme:

- 1 Ambient për zyra me sipërfaqe totale deri në 500 m² ku duhet të përfshihen minimumi 5 zyra të ndara, 1 ambient *co-working* (për disa postacione pune), 1 sallë mbledhjesh, 1 ambient arkive/magazine dhe 4 tualete (të kompletuar me pajisje hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë).
- 2 Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisur me matës të dedikuar të ujit dhe energjisë elektrike.
- 3 Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi të instaluar dhe plotësisht funksional
- 4 Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar (infrastrukturën e rrjetit) si dhe instalime elektrike për çdo post pune.
- 5 Ambiente duhet të jenë të përfunduara dhe të gatshme për përdorim.
- 6 Ambientet duhet të jenë pranë kompleksit të ministrive dhe institucioneve ndërkombëtare në Tiranë.
- 7 Ambienti duhet të ofrojë mundësi zgjerimi modular në rast të rinovimit të kontratës.
- 8 Ambienti duhet të ketë ndriçim dhe ajrim natyral.
- 9 Ambientet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre.
- 10 Ambientet duhet të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi në fushën e shëndetit, aksesueshmërisë dhe sigurisë.

Kritere të preferuara:

1. Mundësia e marrjes me qira të ambienteve në mënyrë modulare ose me faza, duke lejuar zgjerimin gradual të hapësirave të zyrave në përputhje me procesin e rekrutimit të stafit gjatë vitit të parë të operimit.

2. Disponueshmëria e të paktën tre (3) vendeve parkimi të dedikuara për mjetet e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.
3. Disponueshmëria e një salle takimesh ose eventesh publike, me kapacitet rreth 100 persona, e përshtatshme për konferenca, seminare apo aktivitete institucionale.
4. Prania e një sistemi kontrolli të aksesit dhe regjistrimi (check-in) për hyrjen në ambiente, që garanton siguri të përshtatshme dhe akses të kontrolluar.
5. Shërbime, facilitetet apo karakteristika të tjera të objektit që përmirësojnë funksionalitetin e ambienteve, mbështesin punën dhe mirëqenien e stafit, si dhe kontribuojnë në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit operacional, do të konsiderohen përparësi në procesin e vlerësimit.

II. KUSHTE KONTRAKTUALE

- 1 Afati minimal i kontratës së qiradhënies duhet të jetë 12 muaj nga data e marrjes në dorëzim të ambienteve, me të drejtë rinovimi.
- 2 Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.
- 3 Pagesa e qirasë do bëhet çdo muaj në llogarinë në lekë të qiradhënësit, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim, kundrejt lëshimit të faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga Banka Shqiptare e Zhvillimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.
- 4 Shpenzimet operative nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë do të përmbushen nga qiramarrësi.
- 5 Dorëzim i ambientit duhet të bëhet brenda 5 ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.

III. KRITERET E KUALIFIKIMIT

Oferta e qiradhënësit duhet të jetë e shoqëruar me:

- 1 Kërkesë e e subjektit/individit për pjesëmarrje në konkurrim.
- 2 Deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit.
- 3 Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe Gent-planin.
- 4 Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
- 5 Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.

- 6 Vetëdeklarim që subjekti, grupi ku ai bën pjesë apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor penal.
- 7 Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - a. NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe Ekstrat Historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
 - b. Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
 - c. Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime.
 - d. Në ofertën e tij subjekti i interesuar, duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit.
- 8 Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Bankën Shqiptare të Zhvillimit.
- 9 Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve.
- 10 Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH.
- 11 Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve në muaj (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë).

Nr.	Emri (ID dhe/ose NIPT)	Përshkrimi	Njësia	Sipërfaqe totale	Çmimi/ m2	Çmimi total / muaj
		Ambiente me qira	m²			
Çmimi pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH						

IV. AFATI I DORËZIMIT

Të interesuarit (ofertuesit qiradhënës) duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin brenda datës 28.02.2026, në adresën e email info@adb.al.

Oferta fituese do të jetë ajo ofertë e cila, bazuar në kriteret e përcaktuara më sipër, përmbush kërkesat e Bankës Shqiptare të Zhvillimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të përzgjedhë ofertën ekonomikisht më të favorshme për objektin e qirasë, duke marrë në konsideratë jo vetëm çmimin e propozuar të qirasë, por duke u bazuar në një vlerësim tërësor të imazhit institucional, reputacionin publik dhe përputhshmërisë së ambientit me statusin dhe misionin e Bankës së Zhvillimit.